

**BASHKIA LIBRAZHD**  
**DREJTORIA E PLANIFIM TERRITORIT, SHEBIMEVE, PROJEKTEVE DHE TURIZMIT**  
**SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

## **RELACION MBI INVESTIMET NE;** **Infrastruktura Ura + Rruge rurale**

Ne degjesat e realizuara ne kuader te buxhetimit me pjesemarrje (komunitetin) ku pervec problematikave ne fusha te tjera te zhvillimit ekonomik doli si nevojte investimi ne permiresimin e infrastruktures rrugore ne shume fshatra te Bashkise Librazhd. Propozimet per keto investime u perzgjodhen nga vete komuniteti sipas nje klasifikimi per nga rendesia e objekteve , amortizimit te tyre. Ne perfundim te ketyre diskutimeve propozohet nderhyrja ne objektet e infrastruktures rurale si me poshte:

### **1. Ndertim Ures Neshte - Prevall.**

Kjo ure u sherben lidhjes se lagjeve te dy fshatrave per kalimin e lumit Lunik. Mungesa e nje ure ne kete vend eshte kthyer nje pike rreziku per kalimin e banoreve dhe nxenesve. Parashikohet ndertimi i nje ure qe te beje te mundur jo vetem kalimin e kembesoreve por edhe te mjeteve auto.

### **2. Hapje trase + vepra arti ne rrugen Rinas (Faza II)**

Ne kete objekt eshte realizuar faza e pare ne nje gjatesi prej 1500ml ku eshte hapur traseja ne pjesen me te veshtire (shkembore) dhe tani per te bere funksionimin e saj kerkohet te vazhdohet hapja e trasese dhe mure + tombina ne nje gjatesi per rreth 1000ml e cila ben lidhjen e ketij fshati me rruge auto te munguar.

### **3. Rikonstruksion i rrruges L. Sheraj - Aslazi ne Funares, Orenje**

Kjo rruge me gjatesi rreth 550 ml u sherben lagjeve Sheraj , Aslsazi etj te fshatit Funares eshte pjeserisht jashte funksionit. Rikonstruksioni i saj eshte i domosdoshem per arsye te levizjes se banoreve por edhe per kalimin e mjeteve bujqesore gje qe deri tani nuk ka funksionuar. Nderhyrjet ne kete rruge jane ne vendosje tombinash , krijimin e trupit te rruges qe per momentin rreth 180 ml eshte kanal i gjere me permasa 2x1,5m, germim per zgjerim dhe shtrim me cakull per krijim te shtresave te qendrueshme.

### **4. Ure per Lagjen Alla , TogeZ- Kuturman**

Ura lidhese e lagjes “Alla”, Kuturman dhe lagjes “Çota” Togeç per kalimin e zallit te Kuturmanit eshte e domosdoshme pasi keto dy lagje hasin veshtiresi ne levizjen per ne qendrat e banuara. Kalimi i nxenesve per ne shkolle eshte rrezik per jeten e tyre. Kjo rruge lidhese nis tek Ura ekzistuese e Kuturmanit dhe perfundon mbi gryken e tunelit te HEC Rrapunit. Punimet e parashikuara jane ndertim i nje ure betony me hapesire drite Hd~5m , mure mbeshtetese betony, gabione per mbrojtje dhe disiplinim te ujerave siperfaqesore , vendosje te tombinove , dhe ndertim te trupit te rruges ne kete fragment me nje gjatesi rreth 500ml.

#### **5. Rikonstruksion i rruges Ferre, Nj.A.Hotolisht**

Rruga e fshatit Vulcan (lagja Ferre) me nje gjatesi prej 1350ml eshte mjaft e amortizuar ku eshte veshtiresuar levizja e mjeteve auto . Nderhyrja ne vendosje tombino, ndertim mure mbajtese dhe krijim i shtresave te qendrueshme ne kete rruge jane parashikuar per ta kthyer sa me funksionale. Kjo rruge u sherben ne menyre direkte rreth 550 banoreve.

#### **6. Rikonstruksion dhe hapje trase te rruges Lagja Roci - Bogdani**

Rruga qe lidh lagjet Roci dhe lagjen Bogdani ne fshatin Hotolisht Fshat N.A Hotolisht eshte momentalisht jashte funksionit pasi nuk eshte lidhur per mungese traseje ne nje segment prej 400 m dhe amortizuar per pjesen tjeter prej 900ml. Kjo rruge I lidh keto dy lagje duke shkurtuar nje distance prej 4 km. Banoret e ted y lagjeve zoterojne toka bujqesore ne ted y lagjet reciprokisht dhe shfrytezimi I tyre behet I veshtire nga gjatesia e rruges. Ne baze te kerkeses se banoreve dhe verifikimit nga zyra per nevojën e nderhyrjes u konstatua se kjo rruge auto ka nevojë per kryerjen e punimeve si me poshte: - Ndertim muresh mbajtese , vendosje tombinash , germime ne shkemb , hapje traseje etj.

#### **7. Rikonstruksion I rruges se fshatit Spathar.**

Rruga e fshatit Spathar e cila eshte rikonstruktuar me vitin 2009 me nje gjatesi prej 7km ne disa segmente ka nevojë per nderhyrje me vepra arti (mure betoni, tombino, mure guri ). Kjo nderhyrje behet si masa mbrojtese te rruges nga ndikimi i dy perrenjeve qe veprojne ne trupin e rruges. Nje vit me pare reshjet cenuan trupin e rruges duke rrezikuar ta nxjerrin jashte funksionit dhe duke bllokuar levizjen normale te mjeteve auto. Kjo rruge i sherben fshatit Spathar me rreth 1300 banores.

#### **8. Ure per Lagjen Qender Sektor , Babje**

Ura per kalimin e perroit te Qoshkut nga lagja e Qoshkut per tek lagja e Xhamise (Ish Sektor) fshati Babje N.A Qender, eshte e domosdoshme per ndertim pasi, gjithnje ka qene problem per kalimin e banoreve si dhe mjeteve auto nga rruga kryesore e fshatit per ne kete lagje. Ndertimi i kesaj ure do tu sherbeje mbi 20 familjeve qe kane shtepite si dhe tokat bujqesore ne kete lagje. Punimet e parashikuara per realizimin e ketij objekti jane betonet per kembe , mbeshtetes dhe solete ure mure guri mbajtes dhe gabione te cilet do te sigurojne kalim normal te banoreve dhe mjeteve auto.

## **9. Rikonstruksion i rruges Mirake Plane – Shkolla 9 - vjecare, Nj.A.Polis**

Segmenti i rruges Mirake Plane (Ruge nacionale) – Shkolla 9 – vjecare eshte nje segment qe nga struktura eshte bere i veshtire ne funksionim per aresye te pjerresise dhe kthesave.

Sigjate periudhes se dimrit ashtu edhe gjate veres. Per te eleminuar kete keto veshtiresi ne qarkullim te mjeteve eshte parashikuar nderhyrje ne shtresat e ruges duke krijuar nje shtrese betoni me plegme metalike ne nje trashesi deri 15cm ne pjeset problematike. Kjo ruge pervec nxenesve te shkolles u sherben edhe banoreve te fshatit Mirake Katund.

## **10. Rikonstruksion I rruges Dotkove Lunik.**

Rruga e fshatit Dotkove me gjatesi 1215 m , ka demtime te konsiderueshme dhe kerkon punime per per zgjerim rruge, betonim te kanalit anesor te vaditjes, vendosje tombino dhe tubao celiku nen rruge per kanalim e vaditjes dhe per shkarkimin e ujrave. Gjithashtu ne nje pjese te madhe kerkon ndertimin e veprave te artit , si mure mbajtes etj.

### **PERGATITI:**

**DREJTORIA E PLANIFIKIM ZHVILLIMIT TE TERRITORIT, TURIZEM, PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE**

